

KONKURS PËR DIZAJN ARKITEKTUROR DHE URBANISTIK “Shkupi i gjeneratës së re”

Jemi të entuziazmuar të shpallim konkursin ekskluziv që kërkon arkitekt dhe urbanist të rinj për të ri-imagjinuar dhe rimenduar mjedisin e Shkupit. Kjo iniciativë e përbashkët përpiqet të adresojë çështje të tilla si zonat publike të braktisura dhe të lënë anash që mund të rigjallërohen për gjeneratën e re. Ftojme arkitekt të rinj dhe kreativ nën moshën 35 vjeçe për të marrë pjesë në këtë përpjekje dhe për të kontribuar në ri-imagjinimin e strukturës urbane të Shkupit.

1. Historiku:

Shkupi, kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut, ka një trashëgimi të pasur shekullore, historike dhe kulturore. Megjithatë, trazirat politike, ekonomike dhe administrative, fatkeqësitë natyrore dhe tërmeti i vitit 1963, të gjitha këto lanë gjurmët e tyre në pamjen urbane dhe arkitekturore të qytetit. Këto zhvillime çuan në krijimin e bërthamave të reja publike, ndërsa të vjetrat u injoruan dhe u braktisën. Për fat të keq, kjo situatë ka çuar në izolimin e disa vendeve thelbësore publike dhe vendeve arkitekturore. Ky konkurs synon rikthimin dhe rigjallërimin e këtyre fushave, **duke marrë në konsideratë këndvështrimin e gjeneratës së re.**

2. Objektivi:

Qëllimi kryesor i konkursit është të frymëzojë ide inovative të dizajnit arkitektonik dhe urban që rivendosin kontekstin njerëzor të Shkupit dhe ndjenjën e bashkësisë në hapësirat publike: bërthamat urbane dhe rrugët që janë një pjesë e brendshme e kujtesës kolektive. Pjesëmarrësit ftohen të përqendrohen në ri-imagjinimin dhe/ose ri-zhvillimin e këtyre thesareve të Shkupit, të përshtatshme me rrethinën, në mënyrë që të krijojnë një mjedis të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës urbano-arkitekturor. Ndërhyrjet duhet t'i përgjigjen vendit në një mënyrë që nuk degradojnë cilësinë aktuale të jetesës, por thjesht i shtojnë vlerë mjedisit.

3. Lokacionet e zgjedhura:

1. Luna Park
2. Shatërvani i Parkut të Qytetit “Lotus”
3. Ezercë
4. Sheshi “Kubi”
5. Qendra Tregtare “Butel”
6. Rruga “Ilindenska” (nga ndërtesa e Qeverisë deri te shatërvani i parkut të qytetit)
7. Rruga “Ilindenska” (fundi i rrugës në Karpos 4)
8. Rruga e “Plastikave”
9. Shëtitore “Dimitar Vllahov” rreth lumit Vardar (nga ndërtesa e MANU-t deri në stacionin e karburantit Makpetrol)
10. Shëtitore “Parku i Frankofonisë”
11. Shëtitorja Vlae
12. Parkingu rreth “Teatri Komedija”

Pjesëmarrësit janë të lirë të zgjedhin njërin nga lokacionet e lartë përmendura.

4. Përmbajtja e kërkuar

- Përshkrimi i konceptit dhe idesë arkitekturore/urbane (maksimumi 3000 karaktere në dokument Word)
 - Plani i situacionit (përpjesë – 1:2000 ose 1:1000 ose 1:500)
 - Diagrame (analiza)
 - Baza / planimetri (përpjesë - 1:250 ose 1:200)
 - Prerjet (përpjesë - 1:250 ose 1:200)
 - Pamje (përpjesë - 1:250 ose 1:200)
- Opsionale:
- 3D pamje (p.sh. vizualizime, fotografitë e modelit, skica dore);
- *Shënim:** Çdo vizatim grafik duhet të përmbajë informacion për përpjesën
- *Shënim:** Përpjesët e përmendura më lart janë sugjerime, të cilat duhen të përshtaten sipas lokacionit të përzgjedhur.

5. Rregullat dhe udhëzimet hyrëse:

- Konkursi është falas dhe i hapur vetëm për pjesëmarrësit lokal.
- Profesionistët dhe studentët deri në moshën 35 vjeçe mund të konkurrojnë vetëm me një projekt.
- Pjesëmarrësit mund të konkurrojnë me projektet e tyre si individë ose ekipe (deri në 4 persona), të përbërë nga arkitektë, urbanist, projektues peizazhesh dhe profesionistë përkatës.
- Thirrja konsiderohet e vlefshme nëse ka të paktën 5 aplikime. Nëse jo, organizatori ka të drejtë të shtyjë afatin ose të anulojë thirrjen dhe të mos japë çmime për fituesit.
- Në zbatimin e mundshëm të projektit fitues, autorët e projekteve fituese janë të detyruar t'i japin të drejtat autoriale zbatuesit të projektit, i cili do të jetë i detyruar të vazhdojë punën me autorin.
- Vetëm Europe House si organizator kryesor i këtij konkursi do të ketë lidhjen midis identitetit të vërtetë të autorëve dhe kodit të identifikimit dhe betohet të mos e ndajë këtë informacion me jurinë.
- Pyetjet në lidhje me rregullat për konkursin mund të dërgohen në competition@euhouse.mk jo më vonë se 18 shtator. Të gjitha përgjigjet do të publikohen më 25 shtator.
- Propozimet e projektimit do të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes [formularit](#) të disponueshëm/

6. Kërkesat e dorëzimit:

Pjesëmarrësit e interesuar duhet të dërgojnë:

- Një (1) B2 poster prezantimi me orientim vertikal (portrait) (jo më shumë se 150 MB për pdf).
- Një (1) dokument Word me gjithë tekstin e kërkuar.
- Të dy skedarët duhet të shtohen në skedarin zip i cili do të ngarkohet në formularin e dorëzimit.
- Mustër për posterin do të shpërndahen në faqen e internetit jo më vonë se 11 shtator.
- Të gjitha projektet duhet të dorëzohen në formatet e mustrave e dhëna.

Si të merrni pjesë:

Individët ose ekipet të interesuar për të konkurruar duhet të vizitojnë faqen zyrtare të [konkursit](#) ku mund të marrin materialet e nevojshme. Dorëzimi i projektit përfundimtar duke përdorur butonin "Dërgo" të bëhet nga data 11 shtator deri në afatin përfundimtar. Për anonimitet, JU LUTEMI MOS shkruani asnjë informatë personale në skedarin PDF që do të dërgoni. Përdorni vetëm kodin tuaj të identifikimit që do të krijohet gjatë dorëzimit të projektit. Bëhet vetëm dorëzim digjital, nuk ka nevojë për printim.

7. Programi i konkursit/Kriteret e vlerësimit

- **Inovacioni**
Koncepti i dizajnit duhet të përforcojë identitetin unik të zonës së përzgjedhur. Inovacioni në aspektin e programit, formës, materialitetit, organizimit hapësinor, detajimit, etj., do të vlerësohet më lartë.
- **Ndikimi social dhe gjithëpërfshirja**
Zgjidhjet duhet të përpiqen të rrisin lidhjet shoqërore, të nxisin lidhje të bashkësive dhe të kontribuojnë në krijimin e një bote më të mirë përmes dizajnit. Projekti duhet të përfshijë aktivitetet dhe veçoritë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga mosha, aftësitë fizike ose interesat e tyre. Hapësira publike duhet të jetë e qasshme nga të gjithë.
- **Ndjeshmëria kontekstuale**
Pjesëmarrësit duhet të marrin në konsideratë aspektet historike, kulturore dhe sociale të Shkupit gjatë përpilimit të projektit. Për sa i përket hapësirës dhe dizajnit, propozimi duhet të konsiderojë respektimin e kontekstit të lokacionit, duke përfshirë trashëgiminë e tij natyrore dhe kulturore.
- **Karakteristikat e pikave referuese**
Dizajni duhet të ketë një ndikim pozitiv, funksional dhe vizual mbi vizitorin, si dhe kontekstin përreth.
- **Qëndrueshmëria dhe rigjenerimi**
Aspektet e qëndrueshmërisë, arkitekturës së gjelbër dhe restauruese, dizajni biofil, gjithëpërfshirja dhe qasja e lehtë duhet të jenë përbërës kyç të projekteve. Pjesëmarrësit inkurajohen të marrin në konsideratë materialet inovative dhe të qëndrueshme, teknikat e ndërtimit dhe zgjidhjet inteligjente të qyteteve aty ku mund të aplikohen.
- **Prezantim grafik**

Prezantimi i qartë i konceptit është një nga kriteret e rëndësishme të vlerësimit.

7. Orari i Konkurrencës:

- Lançimi i konkursit: **26 korrik 2023**
- Nisja e konkursit: **04 shtator**
- Afati i pyetjeve: **18 shtator**
- Publikimi i përgjigjeve: **25 shtator**
- Afati përfundimtarë i dorëzimi të punimevet: **22 tetor 2023**. 23:59 h
- Vlerësimi i punimeve nga jurija (i brendshëm): **6 nëntor, 2023**

8. Çmimet:

- Çmimi kryesor: 1.500 EUR
- Çmimi i dytë: 800 EUR
- Çmimi i tretë: 500 EUR

9. Juria:

Juria do të qëndrojë anonime për transparencë dhe mbrojtje nga ndikimet deri në ceremoninë e shpalljes së fituesëve.

Anëtarët e jurisë janë profesorë nga: Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodij në Shkup, UACS | Universiteti Kolegji Amerikan Shkup, Universiteti MIT, Universiteti FON UAE.